

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE SHKURT 2026

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesë	Tarifa
11	29.01.2026	<p>Përshendetje! Unë jam XY i, ish-studente në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, e diplomuar në muajin shtator 2025.</p> <p>Duke qenë se kam përfutur bursë bazuar në rezultatet akademike sa rroga minimale për 1 vit, me kushtin e përbushjes së detyrimit të punësimit për tre vite pas diplomimit, do të doja disa sqarime lidhur me këtë detyrim.</p> <p>Aktualisht jam e punësuar, por puna që kryej nuk lidhet drejtpërdrejt me fushën time të studimit. Ju lutem, mund të më informoni nëse kjo përbën problem në lidhje me përbushjen e kushteve të bursës apo nëse kërkohet që punësimi të jetë specifikisht në fushën përkatëse? Gjithashtu çfarë ndodh me diplomën time përgjatë këtyre 3 viteve që nuk e tërheq dot ? Çfarë ndodh nëq një institucion më kërkon diplomën ? Në çfarë muaji të cilit vit më lejohet tërheqja ime e diplomës ?</p> <p>Do ta vlerësoja shumë ndihmën dhe sqarimin tuaj mbi këto çështje, në mënyrë që të jem në përputhje të plotë me rregullat dhe detyrimet përkatëse.</p> <p>Faleminderit paraprakisht për kohën dhe mbështetjen tuaj.</p> <p>Me respekt,</p>	03.02.2026	<p>Përshendetje,</p> <p>Në vijim të emailit tuaj, ju informoj si më poshtë, Në zbatim të pikës 8 të VKM nr. 386/2022, i ndryshuar, përfituesit e mbështetjes financiare janë të detyruar që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga diplomimi dhe deri në përbushjen e plotë të detyrimit trevjeçar të punësimit, të aplikojnë për pozicione të lira pune në institucionet e administratës buxhetore shtetërore dhe në institucionet e pavarura publike.</p> <p>Në këtë kuadër, ju lutemi të na informoni nëse aktualisht jeni e punësuar në sektorin publik apo në sektorin privat..</p> <p>Në rast se jeni e punësuar në sektorin publik, konsiderohet se keni filluar përbushjen e detyrimit trevjeçar të punësimit, pavarësisht nëse pozicioni i punës lidhet drejtpërdrejt ose jo me fushën tuaj të studimit. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se:</p> <p>Diploma origjinale nuk mund të tërhiqet gjatë periudhës trevjeçare të detyrimit të punësimit. Nëse një institucion apo punëdhënës ju kërkon diplomën, mund të përdorni vërtetime ose dokumentacion tjetër zyrtar të lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë. Diploma mund të tërhiqet pas përfundimit të 3 viteve të punësimit, duke filluar nga data e nisjes së marrëdhënies suaj të punës në sektorin publik, pranë institucionit publik të arsimit të lartë ku keni përfunduar studimet e financuara. Në rast se ju keni filluar shlyerjen e detyrimit për punësim në sektorin shtetëror, atëherë ju duhet të përcillni pranë AKFAL fotokopjen e noterizuar të kontratës së punës. Faleminderit,</p>	Përgjigjia jepet e plote	Jo
12	03.02.2026	<p>Pershendetje! Jam XY nxenese ne vitin e pare ne Universitetin Politeknik te Tiranës . Une kam plotesuar formularin paraprak mbi te dhenat per nenshkrimin e marreveshjes trepaleshe per bursen studentore te ekselences . Doja tju pyesja se kur duhet te vij ta nenshkruaj fizikisht marreveshjen ?</p>	03.02.2026	<p>Përshendetje,</p> <p>Duke qenë se numri i studentëve të shkëlqyer të cilët plotësojnë kriteret e VKM nr. 386/2022, i ndryshuar është i lartë, kemi bërë lajmërimë të pjesshme për firmosjen e marrëveshjes tre palëshe. Ju do të njoftoheni në ditët në vijim për firmosjen e marrëveshjes . Faleminderit,</p>	Përgjigjia jepet e plote	Jo
13	03.02.2026	<p>Përshendetje! Çfarë ndodh në rast se në këtë periudhë nuk gjej dot një punë stabël? Pra mund të punoj 6 muaj diku dhe pastaj një periudhë tjetër diku tjetër ? Po në rast se një periudhë qëndroj e papunësuar ? Marim shembull që në periudhën 3 vjeçare jam 1.5 vjet e punësuar dhe 1.5 tjetër e papunësuar. Mund ta tërheq diplomën pas 3 vitesh në këtë rast edhe pse kam kaluar një periudhë si e papunësuar ?</p>	04.02.2026	<p>Përshendetje,</p> <p>Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju informojmë si më poshtë: Detyrimi i përfituesve të mbështetjes financiare konsiston në përbushjen e tre (3) viteve pune në sektorin publik, i cili fillon nga data e nisjes së marrëdhënies së parë të punës në një institucion të administratës buxhetore shtetërore ose në një institucion publik të pavarur. Periudhat e punësimit nuk është e domosdoshme të jenë të pandërprera. Punësimi mund të realizohet në institucione të ndryshme publike, për sa kohë që në total përbushet afati trevjeçar i punësimit .</p> <p>Periudhat e papunësisë nuk përfshihen në llogaritjen e afatit të detyrimit trevjeçar të punësimit. Në rastet kur përfituesi nuk është i punësuar, afati i përbushjes së detyrimit pezullohet dhe rifillon në momentin e nisjes së një marrëdhënieje të re pune në sektorin publik. Për rrjedhojë, nëse brenda një periudhe kohore 3-vjeçare kalendarike përfituesi ka qenë i punësuar vetëm për një pjesë të saj (p.sh. 1.5 vite i punësuar dhe 1.5 vite i papunësuar), detyrimi konsiderohet i përbushur vetëm pas plotësimit të 3 viteve reale pune në sektorin publik, pavarësisht kohëzgjatjes kalendarike.</p> <p>Diploma origjinale nuk mund të tërhiqet gjatë periudhës së përbushjes së detyrimit trevjeçar të punësimit. Tërheqja e saj mund të kryhet vetëm pas përfundimit të plotë të këtij detyrimi, duke filluar nga data e nisjes së marrëdhënies së parë të punës në sektorin publik. Faleminderit</p>	Përgjigjia jepet e plote	Jo

14	04.02.2026	<p>Pershendetje! Jam nje nder studentet te cilet permbush kriteret per perfitimin e burses se ekselences sa paga minimale. Kam dorezuar te gjitha dokumentacionin e nevojshem por nuk kam marr asnje njoftim. Ju lutem,jam ne pritje te nje pergjigje! Faleminderit per mirekuptimin!</p>		<p>I nderuar student, Ju jeni shpallur perfitues i mbeshitetjes financiare per vitin akademik 2025-2026 pasi plotesoni kriterin 2/a te VKM nr.386/2022, i ndryshuar. Lutemi nga ana juaj te paraqiteni pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë në datë 09.02.2025 deri në datën 13.02.2026 për nënshkrimin e marrëveshjes tre palëshe (AKFAL- IAL- Student). Ju mund të paraqiteni në datat e caktuara, brenda orarit zyrtar nga ora 8:00-16:30 nga e hëna në të enjte dhe 8:00-14:00 të premte, në adresën: Rruga "Naim Frashëri", nr.37, Tiranë. Duhet të jeni të pajisur me kartën ID, ose pasaportë personale të vlefshme, Ju kërkohet të shprehni dakortësinë tuaj për nënshkrimin e marrëveshjes tre palëshe, nëpërmjet emailit Faleminderit ,</p>	Pergjigjia jepet e plote	Jo
15	11.02.2026	<p>Pershendetje! Shpresoj të jem duke ju gjetur mirë. Unë jam XY studente e vitit të dytë në degën e Fizikës, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër. Gjatë dy viteve të para të studimit kam përfituar bursën për degët prioritare. Dëshiroj të informohem nëse kjo bursë vazhdon edhe për vitin e tretë të studimeve, si dhe rreth afatit kohor se kur pritet të kryhet dhënia e bursës për këtë vit akademik, pasi deri më tani nuk kam marrë një përgjigje konkrete nga institucionet përkatëse ketu ne Shkoder . Ju lutem, nëse është e mundur, të më informoni për procedurën, statusin aktual të bursës dhe afatet e parashikuara. Ju falënderoj paraprakisht për kohën dhe ndihmën tuaj. Me respekt,</p>	12.02.2026	<p>Përrshendetje, Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se, bazuar në statusin tuaj si përfitues e bursës për degët prioritare dhe në vijimësinë e studimeve në të njëjtin program, ju vijoni të jeni përfitues e kësaj burse edhe për vitin e tretë akademik. Ju bëjmë me dije se fondi përkatës është transferuar nga Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) pranë universitetit tuaj, për vijimin e procedurave të pagesës. Për informacion më të detajuar lidhur me afatin e disbursimit dhe procedurat administrative konkrete, ju lutemi të interesoheni pranë strukturave financiare përkatëse në Universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër, pasi administrimi i mëtejshëm i fondit kryhet nga institucioni juaj. Duke ju uruar suksese në vijim të studimeve. Faleminderit,</p>	Pergjigjia jepet e plote	Jo
16	12.02.2026	<p>I nderuar/ e nderuar, Unë jam studente e vitit të katërt në programin e Mjekësisë së përgjithshme dhe po ju drejtohem për të marrë informacion lidhur me mundësinë e përfitimit nga Mbeshitetja Financiare e ofruar nga AKFAL. Aktualisht kam firmosur kontratën e punës së detyruar sipas legjislacionit në fuqi dhe do të doja të dija nëse ekziston mundësia që të aplikoj ose të përfitoj nga skema e mbeshitetjes financiare (30.000 lekë/muaj), duke qenë se nuk kam aplikuar në tjeret e mëparshme. Ju lutem më informoni nëse: Ka thirrje të hapura aktualisht për studentë të vitit të katërt; Është e mundur aplikimi për vitet e mbetura të studimit; Cilat janë kriteret specifike që duhet të plotësoj. Ju falënderoj paraprakisht për kohën dhe informacionin që do të më jepni. Me respekt,</p>	13.02.2026	<p>Përrshendetje ,, Ju falënderojmë për mesazhin tuaj dhe ju urojmë suksese të mëtejshme në studimet tuaja në programin e Mjekësisë së Përgjithshme. Në lidhje me pyetjet tuaja, ju sqarojmë se, sipas përcaktimeve të VKM nr. 386/2022 për skemën e mbeshitetjes financiare për studentët e ekselencës dhe programet prioritare, përfitimi nga kjo skemë realizohet në momentin e regjistrimit në vitin e parë të studimeve, nëse studenti plotëson kriteret përkatëse dhe lidh marrëveshjen trepalëshe sipas legjislacionit në fuqi. Për rrjedhojë, studentët që nuk kanë aplikuar dhe nuk janë përfshirë në skemë në vitin e parë të studimeve, nuk mund të përfitojnë në vitet pasuese të ciklit të studimit. Gjithashtu, aktualisht nuk ka thirrje të hapura për studentë të vitit të katërt. Për informacion, kriteret që aplikoheshin në momentin e nisjes së studimeve përfshinin: Mesatare 10 gjatë tre viteve të arsimit të mesëm; Nota e provimeve të Maturës Shtetërore jo më pak se 9.5; Ruajtja e një mesatareje jo më pak se 9.5 gjatë çdo viti akademik, për vijimin e përfitimit. Shpresojmë që sqarimet e mësipërme t'ju kenë ndihmuar. Për çdo informacion tjetër, mbetemi në dispozicion. Me respekt,</p>	Pergjigjia jepet e plote	Jo

17	16.02.2026	<p>Pershendetje! Jam nje studente e UBT viti pare .perfituese e burses per lendet prioritare. Problemi qendron se kam nje lende te prapambetur per frekuentim per te cilen nuk kam dhene as provimin e lendes dje. Arsyeja eshte se punoj ne shtet me turme dhe skam mundur ti ndjek cdo leksion te lendes ne fjale, per kete fakt mund te paraqes dhe nje vertetim pune prane zyres kompetente ne menyre qe te vazhdoj te marr bures per 3 vitet e shkolles. Pres nje pergjigje nga ju,</p>	20.02.2026	<p>E nderuar studente, Në pergjigje të email-it tuaj, ju informojmë se vijimi i përfitimit të mbështetjes financiare për programet prioritare rregullohet nga VKM nr. 386/2022, i ndryshuar, si dhe nga Udhëzimi nr. 30, datë 04.11.2022, i ndryshuar. Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe me marrëveshjen e nënshkruar, përfitimi i mbështetjes financiare kushtëzohet nga: përbushja e plotë e detyrimeve akademike të vitit përkatës; realizimi i progresit të rregullt në programin e studimit. Konkretisht, referuar Nenit 4 “Të drejtat dhe detyrimet e përfituesit”, pika c, të marrëveshjes, përcaktohet se: “Në rast të mosshlyerjes nga ana e përfituesit të të gjithë detyrimeve akademike të vitit akademik, ai/ajo e humb të drejtën e përfitimit të mbështetjes financiare për vitin akademik pasardhës.” Për sa më sipër, vijimi i mbështetjes financiare për vitet pasardhëse është i mundur vetëm nëse janë përbushur të gjitha detyrimet akademike dhe është realizuar progres i rregullt në programin e studimit. Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,</p>	Pergjigjia jepet e plote	Jo
18	16.02.2026	<p>Pershendetje,jam e interesuar per t ju pyetur mbi dicka.Aktualisht studioj ne nje universitet privat ne nje program inxhinierie,viti i pare.Nese crregjistrohem dhe vitin tjeter kaloj ne shtet (dega mjekesi)ja e perfitoj bursen e ekselences nese jam fituese e medaljes se arte?</p>	16.02.2026	<p>Përsëndetje, Në vijim të emailit tuaj, ju informojmë se: Nëse ç’rejistrohemi nga programi i studimit që po ndiqni aktualisht, dhe në vitin pasardhës regjistrohemi në një program studimi në universitet publik (dega Mjekësi), si dhe plotësoni kriterin 2/a të VKM nr. 386/2022, i ndryshuar, atëherë mund të përfitonit mbështetje financiare në masën e pagës minimale, sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Faleminderit,</p>	Pergjigjia jepet e plote	Jo
19	16.02.2026	<p>Pershendetje, kam realizuar aplikimin per Mbeshteje Financiare si studente e Deges Matematikes ne Universitetin Luigj Gurakuqi. Aplikimi im eshte bere me 6 Janar 2026, nga ajo date skam marre asnje pergjigje. Ju lutem me informoni si duhet te veproje per hapet e metejshem. Bashkengjitur po ju dergoje edhe numerin e Aplikimit!</p>	16.02.2026	<p>Përsëndetje, Në pergjigje të email-in tuaj lidhur me aplikimin për Mbështetje Financiare si studente e Degës së Matematikës pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, ju bëjmë me dije se afati zyrtar i aplikimit për skemën e mbështetjes financiare ka përfunduar më datë 20 dhjetor 2025. Aplikimi juaj, i paraqitur më 6 janar 2026, është regjistruar pas përfundimit të afatit të përcaktuar. Për këtë arsye nuk mund të merret në shqyrtim në kuadër të këtij cikli aplikimi. Faleminderit për mirëkuptimin!</p>	Pergjigjia jepet e plote	Jo